



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr. 04 Datë: 06.04.2022

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2021 TË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR


Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2022, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit", Ligjin 137/2020 "Per Buxhetin e Vitit 2021", VKQShkoder nr.16, datë 30.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit te Këshillit te Qarkut Shkodër për vitin 2021 dhe PBA Përfundimtare 2021-2023", Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj.

Pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **11 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I ;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 dhe tabelat e realizimit të buxhetit , pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve



Projektet e investimeve me financim të brëndshëm.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Hilmi LAKTI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Shkodër me 22/02/2022

Raport mbi zbatimin e monitorimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për periudhën 12/mujore Janar – Dhjetor 2021

1- Hyrje

Realizimi i buxhetit për Këshillin e Qarkut Shkodër Buxhetit për periudhën 12/mujore, Janar – Dhjetor 2021, është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisje Vendore", nenin 48 të Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe Udhezimin nr 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit te Njësite të Vetëqeverisjes Vendore", si dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr.16, datë 30/12/2020 "Mbi miratimin e buxhetit të KQSH për vitin 2021".

Qarku, si njësi e nivelit të dytë të Vetëqeverisjes Vendore, ushtron funksionet e veta për ndërtimin e zbatimit e politikave rajonale duke bërë harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) si dhe kryen funksione të tjera që i delegohen nga bashkitë e qarkut apo pushteti qendror në zbatim të marreveshjeve të lidhura mes palëve.

Programi Buxhetor Afatmesem, parashikon mbulimin sa me efikasitet të funksioneve të tij, për të zbatuar politikat dhe misionin e ngarkuar.

Këshilli i Qarkut Shkodër, menaxhon fondet duke u bazuar në programet e mëposhtme ;

- ✓ **P1-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim).**
- ✓ **P1-01160-Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (DAMT).**
- ✓ **P8- 04520-Programi i Rrjetit Rrugor.**
- ✓ **P9-04760- Programi për Mbeshtetje dhe implementim i projekteve në kuadër të politikave rajonale për zhvillim në fushën e turizmit**
- ✓ **P16-06330-Programi i furnizimit me ujë.**
- ✓ **P25-10460-Programi në fushën e Shërbimeve të Përkujdesjes në qarqe**

2- Përshkrim i Përgjithshëm mbi procesin e monitorimit dhe realizimi i buxhetit.

Sipas nenit 38 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika 1 dhe 2, qarku krijon të

ardhura nga burimet e veta vendore dhe te ardhura qe rrjedhin nga burime kombetare.

Të ardhurat nga përgjithshme vendore per vitin 2021 janë

- Transferta e pakushtezuar per kryerjen e funksioneve te KQSh është 56,661 mijë lekë.
- Transferta e kushtezuar per kryerjen e funksioneve te deleguara është 5,592 mijë lekë.
- Tarifa per shërbime Publike e planifikuar 300 mijë lekë dhe kuota e antarësisë e përcaktuar me VKB të 5 njësisive vendore të qarkut Shkodër është 2,940 mijë lekë.
- Të ardhura të trashëguara nga viti 2020 ne shumën 41,618 mijë lekë

Për vitin 2021, të Ardhurat e planifikuara të Këshillit të Qarkut Shkodër, kanë qenë 3,240 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga shërbimet 300 mijë lekë dhe nga Kuota e Antarësisë për Bashkitë e qarkut Shkodër në masën 2,940 mijë lekë, sipas Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 3, datë 08.04.2021 dhe shprehje ligjore nr. 335/1, datë 21.04.2021.

Jane lidhur marrëveshjet me Bashkitë Shkodër, Pukë dhe Fushe Arrëz ndërsa dy Bashkitë Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës, edhe pse i jane dërguar marrëveshjet për firmë, akoma nuk janë sjellë të firmosura dhe si rrjedhore nuk është realizuar arkëtimi i kuotës së planifikuar për kuotën e qarkut.

a-Realizimi i të Ardhurave.

Te ardhurat e realizuara deri me **31.12.2021** në lekë, paraqiten si me poshtë;

- Te ardhura nga kuota e antaresise	1,139,629 leke
- Të ardhura nga sherbime kadastrale	40,000 lekë
- Të ardhura nga konfirmim hartash	43,000 lekë
- Te ardhura nga nxjerrje doc.arshivore	9,000 leke
- Te ardhura Gjithsej	1,232,629 leke

Kuota e antarësisë e miratuar në mbledhjen e Keshillit të Qarkut Shkodër me datën 08.04.2021, nga Bashkitë e qarkut Shkodër është;

➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	1,600,000 lekë
➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	2,940,000 leke

Plani total i të ardhura për 12/mujorin i planifikuar në shumën 3,240 mijë lekë, është realizuar në masën 1,232 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave është 38.03 %, nga sa ka qenë i planifikuar.

Plani analitik i të Ardhurave dhe realizimi per 12/mujorin e vitit 2021, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme;

Në 000/lekë

Nr	EMERTIMI	Plani	Plani	Fakti	Realizimi
		12/mujor	12/mujor	8/mujor	Ne %
1	Te ardhura nga kuota Qarkut per 2021	2,940	2,940	1,140	38.78%
2	Te ardhura nga sherbime të DAMT	100	100	40	40%
3	Te Ardh.konf.hartash	100	100	43	43 %
4	Tarifanxj.Doc.arshivore	100	100	9	9 %
Totali		3,240	3,240	1,232	38.03%

Siç shihet nga tabela e mesiperme:

Te Ardhurat e planifikuara për periudhën 12/mujore kane qene 3,240mijë lekë dhe janë realizuar në masën 1,232 mijë lekë ose 38.03 % e tyre.

Efektin më të madh në realizimin e të ardhurave e ka dhene pagesa e e taksës së Qarkut e bërë nga Bashkia Shkodër në masën e planifikuar 1,000 mijë lekë si dhe Bashkia Puke në masën e planifikuar 40 mijë lekë dhe Bashkia Fushë Arrëz, planifikuar në masen 100 mijë lekë dhe realizuar në masën 99,629 lekë.

Nga sa më sipër realizimi i Taksës së qarkut paraqitete si më poshtë;

	Plani	Realizimi
Bashkia Malësi e Madhe	shuma 200,000 lekë	0 lekë
Bashkia Vau Dejës	shuma 1,600,000 lekë	0 leke
Bashkia Shkodër	shuma 1,000,000 lekë	1,000,000 lekë
Bashkia Fushë Arrëz	shuma 100,000 leke	99,629 lekë
Bashkia Pukë	shuma 40,000 leke	40,000 leke
Totali	2,940,000 leke	1,139,629 lekë

Te ardhurat që janë planifikuar për kryerje shërbimesh, si efekt i kompetencave ligjore qe kane qarqet, jane pothuaj të pakonsiderushme.

➤ Të ardhura nga shërbimet kadastrale ishin planifikuar në masën 100 mijë lekë dhe janë realizuar 40 mijë lekë ose 40% e tyre. Kjo si rezultat i uljes së kërkesave për dokumente kadastrale.

➤ Të ardhura nga shërbimet për konfirmime hartash, ishin planifikuar në masën 100 mijë lekë dhe janë realizuar 43 mijë lekë ose 43% e tyre. Kjo si rezultat i uljes së kërkesave për dokumentet që disponon institucioni ynë.

➤ Të ardhura nga shërbimet për nxjerrje dokumentesh arshivore, ishin planifikuar në masën 100 mijë lekë dhe janë realizuar 9 mijë lekë ose 9% e tyre. Kjo si rezultat i uljes së kërkesave për dokumentet që disponon institucioni ynë.

b-Realizimi i shpenzimeve buxhetore.

Gjatë 12/mujorit të vitit 2021 në Keshillin e Qarkut janë realizuar shpenzimet sipas programeve të planifikuara buxhetore sic janë ;

- ✓ **P1-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut** (Planifikim, menaxhim, administrim).
- ✓ **P2-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut ,funksion i deleguar(DAMT).**
- ✓ **P8- 04520- Programi i Rrjetit Rrugor.**
- ✓ **P9-04760- Programi për Mbeshtetje dhe implementim i projekteve në kuadër të politikave rajonale për zhvillim në fushën e turizmit**
- ✓ **P16-06330- Programi i furnizimit me ujë.**
- ✓ **P25-10460- Programi në fushën e Shërbimeve të Përkujdesjes në qarqe.**

Sic shihet nga aneksi nr. 1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve", realizimi i buxhetit për vitin 2021, është në masën 32.88 %. Kjo kryesisht si rezultat i Programit P16- Programi i furnizimit me ujë, pasi investimi i planifikuar për tu realizuar për ujęsjellësin e Muriqanit në bashkëpunim me AKUM, nuk u realizuar si rezultat i pakësimit të fondeve nga AKUM.

3- Realizimi sipas Programeve;

- ✓ **P1-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut** (Planifikim, menaxhim, administrim)

Ky program përfshin planifikimin, menaxhimin nga ana e administrative të institucionit tone, për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të kuadrit ligjor në fuqi.

Sic shihet nga aneksi 2, Buxheti vjetor i rishikuar 2021 për këtë Program është 39,756 mijë lekë ose 34.39 % e buxhetit total të Këshillit të Qarkut Shkodër.

Ky program përfshin;

- Shpenzimet e personelit nga tranferta e pakushtezuar e vitit 2021. Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së KQShkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore të cilat për 12/mujorin e këtij viti, shpenzimet për paga, janë realizuar në masën 90.84%, ndërsa për sigurime shoqërore janë realizuar në masën 89.64 %. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua në numrin e punonjësve i cili për keshillat e qarqeve është përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit me 10 punonjës administrativ dhe 3 të zgjedhur si dhe në nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, brënda kufirit minimal dhe maksimal të miruar. Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 165, datë 02.03.2016, i ndryshuar dhe në zbatim të VKQShkodër nr.14, datë 30.12.2020.
- Shpenzimet operative janë planifikuar për 12/mujorin në masën 10.919 mijë lekë dhe janë realizuar 6048.45 mijë lekë.
Realizimi i aktiviteteve të këtij programi për shpenzimet operative për funksionimin e administratës së qarkut Shkodër është realizuar në masën

55.40 % .Realizimi i ulët i shpenzimeve operative ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa aktiviteteve sociale të planifikuara për të realizuar gjatë vitit 2021 por si rezultat i masave për gjendjen e pandemisë nuk janë realizuar.

Për këto aktivitete ka qenë planifikuara shuma prej 750 mijë lekësh dhe nuk janë realizuar.

Pjesa tjetër e fondeve ka mbetur kryesisht nga diferencat e prokurimeve të fondeve. Po kështu, nuk është realizuar edhe aktiviteti nr. 24 i buxhetit për "Muzeumin Etnografik Shkodër" i planifikuara në shumën 1,000 mijë lekë.

- Transferta korrente të brendshme , ze i cili përfshin transferata që Këshilli i Qarkut Shkodër bën në zbatim të VKM-ve dhe Vendimeve të Këshillit. Për 12/ mujorin e këtij viti ishte planifikuara vlera 700 mijë lekë, realizimi është 700 mijë lekë. Pjesa tjetër e fondeve në shumën 2,795 lekë janë fonde nga të ardhurat e planifikuara ndër vite, të cilat janë pakësuar me vendim të KQShkodër të datës 30.12.2021.
- Transferta korrente të jashtme përfshijnë kuotacionet që qarku paguan ndaj organizatave partnere ku aderohet si CPMR dhe EUSAIR . Për 12 mujorin ishte planifikuara shuma prej 320 mijë lekësh, Realizimi është 317.93 mijë lekë , ose është realizuar në masën 99.36%.
- Transferta tek buxh familjare përfshin shumën që i paguhen punonjësve për persona në ngarkim sipas VKM-së nr. 499, datë 13.08.1998, i nryshuar. Për 12/mujorin e këtij viti është planifikuara shuma 30 mijë lekë dhe është realizuar shuma 30 mijë lekë , ose realizimi në masën 100%.
- Në shpenzime kapitale të këtij programi janë planifikuara shpenzime për paisje zyrash, orëndi dhe blerje kompjuterash, të cilat janë planifikuara në këtë 12/mujor në masën 302 mijë lekë dhe janë realizuar 201 mijë lekë ose në masën 66.6 %.
- Në shpenzimet kapitale të këtij programi, është planifikuara nga të ardhurat investimi "Rrethimi e sistemimi i varrezave të qytetit Pukë, për vitin 2021, në vlerën 4,080 mijë lekë. Të ardhurat e realizuara për këtë investim për vitin 2021 janë 239,629 lekë ose 5.88% e tyre. Si rrjedhojë edhe ky investim nuk është realizuar në vitin 2021 për mungesë fondesh.
- Në shpenzimet kapitale me financim të huaj , janë fonde të mbetura në Kap.6, të trashëguara ndër vite si diferenca nga disa projekte të huaja, në shumën 610 mijë lekë.

Realizimi total i këtij programi për 12 mujorin e këtij viti, ka qenë në masën 58.27 %.

P2-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (DAMT).

Këshilli i Qarkut Shkodër, në varësi të tij ka edhe DAMT-në , i cili ushtron aktivitetin e vet me fonde të kushtëzuara nga Ministria e Brëndshme .

Zbatimi i Buxhetit për periudhën janar deri 31 dhjetor 2021, është i pasqyruar në Aneksin 2. program 01160.

Ky program përfshin;

- Koston e personelit nga tranferta e kushtezuar e vitit 2021 e cila për 12/mujorin e këtij viti, për paga është realizuar në masën 86.68%, ndërsa për sigurime shoqërore është realizuar në masën 92.93 %. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve i cili për DAMT, është i përcaktuar me 6 punonjës administrativ dhe në nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017.
- Shpenzimet operative të cilat për 12/mujorin, janë planifikuar në masën 279 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 238.19 mijë lekë ose realizuar 85.38%. Diferenca e mbetur është si pasojë e diferencës së prokurimeve në sistem.
- Është bërë shtesë fondi, Transferta tek buxh familjare nga transferta e kushtezuar, për shpërblimin e një punonjësi i DAMT-së i cili ka dale në pension, në masën 82 mijë leke dhe është realizuar 100%.

Realizimi total i këtij programi për 12 mujorin e këtij viti, është në masën 87.65 % .

P8- Programi i rrjetit Rrugor.

Në këtë program, në buxhetin e vitit 2021 është planifikuar investimi në Bashkinë Fushë Arrëz” Rikonstruksion, asfaltimi rrugëve të brendshme në qytetin e Fushë Arrësit“ në shumën 4,000 mijë lekësh.

Ky investim me objekt “Rikonstruksion, Asfaltim i Rrugëve të Brendshme” në Qytetin Fushë- Arrëz, me vlerë kontrate me tvsh 3,568,325 lekë është realizuar në masën 100% të investimit.

Pjesa tjetër e fondeve sipas aneksit 2 të këtij programi, në shumën 2,468 mijë lekë, janë diferenca prokurimesh me destinacion.

Për këtë program, për 12/mujorin, është realizuar 100% vlera e investimit e planifikuar.

P9-Programi për Mbeshtetje dhe implementim i projekteve në kuadër të politikave rajonale për zhvillim në fushën e turizmit

Këshilli i Qarkut Shkodër, për vitin 2021 ka planifikuar fonde për bashkëfinancime me projekte me financim të huaj në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave për Projektet me Financim të Huaj nr.35, datë 21.09.2020.

Meqenese në kemi aplikuar në disa projekte kryesisht në fushën e turizmit, kemi bërë planifikimin në këtë program në shumën 500 mijë lekë nga Transferta e Pakushtezuar e vitit 2021 dhe 3,434 nga të Ardhurat e trashëguara për tu realizuar dhe të ardhurat e vitit 2021.

Gjatë këtij viti kemi qënë pjesë e projektit “Përmirësimi i cilësisë dhe vizibilitetit të destinacionit Majat e Ballkanit, me standarde të larta orientuar për tregun e turizmit”, në zbatim të VKQShkodër nr 7, datë 22.07.2021 dhe në zbatim të Akt Marrëveshjes nr 310, datë 29.06.2021, ndërmjet shoqatës Alpinistike Marimangat e Pejës, CODE Partners dhe Këshillit të Qarkut Shkodër për realizimin e aktiviteteve të këtij projekti sipas buxhetit të tij.

Per periudhën 12 mujore, kemi planifikuar shumën prej 500 mijë lekësh dhe kemi realizuar shumën prej 122 mijë lekësh nga Buxheti I KQShkodër.

Për projektin ADRIATICAVES, i cili ka përfunduar me 31 mars 2021, është transferuar nga viti 2020 shuma prej 1,740,913 leke për aktivitete për projektin dhe është realizuar shuma 747 mijë lekë. Edhe gjatë vitit 2021 pas validimit të fondeve të projektit është arketuar shuma 643 mijë lekë të cilat trashëgohen në vitin 2022.

P16-06330-Programi i furnizimit me ujë.

Në buxhetin e vitit 2021, kemi planifikuar fonde për hartimin e projektit “Ndertimi i Ujësjellësit Muriqan, Bashkia Shkodër” në shumën 51,361 mijë lekësh për vlerë investimi përfshirë edhe mbikqyrjen dhe kolaudimin e investimit.

Në zbatim të marreveshjes së lidhur mes Këshillit të Qarkut Shkodër dhe AKUM, me shkresën nr. 340, datë 12.02.2021 të Min. Infrastrukturës dhe Energjisë, është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2021 në shumën 10,983 mijë lekë vlerë investim dhe 259 mijë lekë për supervizion punimesh. Gjithashtu në këtë shkresë është dërguar edhe shuma e parashikur në PBA për vitet 2022 dhe 2023 respektivisht 10,983 mijë lekë vlerë investim dhe 259 mijë lekë për supervizion punimesh për vitin 2022 dhe 32,949 mijë lekë vlerë investim dhe 777 mijë lekë për supervizion punimesh për vitin 2023.

Për Investimin e planifikuar në buxhetin e vitit 2021 për “Ndertimi i Ujësjellësit Muriqan, Bashkia Shkodër” me datën 26.04.2021 është miratuar leja e ndertimit të objektit nga Bashkia Shkodër dhe kemi filluar me kryerjen procedurave për hedhjen e prokurimit në app. Pa asnjë njoftim nga Min. Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM, në rakordimin 5/mujor me Degën e Thesarit u njoftuam për tërheqje të fondeve dhe perkatsisht 7,013 mijë lekë si dhe fondet e planifikuar në PBA për vitet 2022 dhe 2023.

Për këtë arsye meqenëse investimi do të behët me vlerën e plotë e cila sipas preventivit është 98,181 mijë lekë dhe ne nuk i kemi patur të gjitha fondet në dispozicion për ta realizuar atë, ky investim nuk është realizuar. Për këtë investim është shpenzuar shuma prej 200 mijë lekë për marrje leje mjedisore.

✓ P25-10460- Programi në fushën e Shërbimeve të Përkujdesjes në qarqe.

Për vitin 2021, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është akorduar fondi në shumën 3,024 mijë lekë për periudhën 6/mujore me shkresën nr. 899/2, datë 19/02/2021 “Transferim i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qarqe për periudhën janar – Qeshor 2021”, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, të cilat do të përdoren për shpenzime korrente sipas nevojave të shtëpisë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”. Këto shpenzime do të përdoren për paga dhe sigurime shoqërore për 3 kujdestarë dhe një logopedist si dhe pagesa për orë nate, festa zyrtare dhe vështirësi pune për punonjësit e kësaj qendre.

Për 6/mujorin e dytë të vitit 2021, me shkresën nr. 630/31, datë 18/06/2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Njoftim”, dhe shkresën nr.333/42, datë 30.06.2021

8

Akordimi i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit në Qarqe për 6 mujorin e dytë”, janë akorduar fondet në shumën 3,024 mijë lekë, po për shpenzime korrente sipas nevojave të shtëpisë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”.

Për periudhën 12/mujore janë transferuar nga MSHMS (transferte e kushtëzuar) shuma prej 6,047 mijë lekë dhe është realizuar shuma prej 5,241.62 mijë lekë ose është realizuar 86.7% e fondeve të transferuara plan.

Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, ushtron aktivitetin e saj prej 25 vitesh dhe strehon 17 persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritetit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qënder janë;

- ✦ Shërbimi rezidencial,
- ✦ Shërbimi mjekësor
- ✦ Shërbimi psiko-social,
- ✦ Aktivitete sociale ,kulturore,vizita
- ✦ Shërbimi sanitar.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"
KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke

12 mujori I vitit 2021

Kodi i Grupit 2033001

Emri i Grupit		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore						
Titulli	Programet	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 mujore/progressiv	(6) Fakti i Periudhes 12 mujore/prog resiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
0001	Programi 1	24,471.0	32,430.0	36,816.0	39,756.0	39,756.0	23,163.7	-16,592.3
0002	Programi 1	5,207.0	5,585.0	5,592.0	5,674.0	5,674.0	4,972.8	-701.2
0003	Programi 8	12,507.0	0.0	6,468.0	6,468.0	6,468.0	3,568.0	-2,900.0
0004	Programi 9	0.0	1,200.0	5,675.0	6,318.0	6,318.0	869.0	-5,449.0
0005	Programi 16	790.0	25,236.0	62,603.0	62,603.0	51,361.0	200.0	-51,161.0
0006	Programi 25	1,993.0	0.0	3,024.0	6,047.0	6,047.0	5,241.6	-805.4
.....							
Totali i Shpenzimeve të Njesisë		44,968.0	64,451.0	120,178.0	126,866.0	115,624.0	38,015.1	-77,608.9
Totali		44,968.0	64,451.0	120,178.0	126,866.0	115,624.0	38,015.1	-77,608.9




Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Hilimi LAKTI
	Firma	
	Data	02.02.2022

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

QARKU	SHKODER	KESHILLI QARKUT SHKODER						Kodi i Grupit / Njesisë Vendore	2033001
Programi 1	01110	-1	-2	-3	-4	-5	-6	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 Mujore/progresiv	Fakti i Periudhes 12 mujore/progresiv	Diferenca	
600	Paga	13633	15000	15000	15000	15000	13625.38	-1374.62	
601	Sigurime Shoqërore	2213	2500	2500	2500	2500	2240.95	-259.05	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7174	10000	10939	11939	11919	6048.45	-5870.55	
609	fond rezerve	0	1500	1500	1500	1500	0	-1500	
604	Transferta Korente të Brendshme	700	900	3495	3495	3495	700	-2795	
605	Transferta Korente të Huaja	521	300	300	300	320	317.93	-2.07	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	35	30	30	30	30	22962.71	-11801.29	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	24276	30230	33764	34764	34764	0	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara	195	2200	2442	4382	4382	200.95	-4181.05	
231	Kapitale të Trupëzuara							0	
232	Transferta Kapitale								
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	195	2200	2442	4382	4382	200.95	-4181.05	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	-610	
Totali	Shpenzime Kapitale	195	2200	3052	4382	4382	200.95	-4791.05	
	Totali (korrente + kapitale)	24471	32430	36816	39756	39756	23163.66	-16592.34	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjjana Miruku	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore	Hilimi LAKTI
Firma		Firma	
Data	22.02.2022	Data	22.02.2022

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

QARKU	SHKODER- DAMT									Kodi i Grupit / Njësishë Vendore	2033001
Programi 1	01160									Kodi i Programit
Art.	Emertimi		-1	-2	-3	-4	-5	-6	(7)=(6)-(5)	Diferenca	
	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 Mujore/progressiv	Fakti i Periudhes 12 mujore/progressiv					
600	Paga	4263	4500	4577.4	4577.4	3967.48	609.92				
601	Signime Shoqërore	712	740	713	713	662.57	50.43				
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	232	345	279	279	238.19	40.81				
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0				
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0				
605	Transferta Korente të Hueja	0	0	0	104.6	104.6	0				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0	0	104.6	104.6	0				
Nen - Totali	Shpenzime Korrente	5207	5585	5592	5674	4972.84	-701.16				
230	Kapitale të Patrupëzuara										
231	Kapitale të Trupëzuara										
232	Transferta Kapitale										
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0				
230	Kapitale të Patrupëzuara										
231	Kapitale të Trupëzuara										
232	Transferta Kapitale										
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0				
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0				
	Totali (korrente + kapitale)	5207	5585	5592	5674	4972.84	-701.16				
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Kryetari Njësishë Vetëqeverisjes Vendore		Hilimi LAKTI								
Firma	22.02.2022		Firma								
Data	22.02.2022		Data								

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/leke

KESHILLI QARKUT SHKODER

QARKU	SHKODER		Kodi i Grupit / Njësishë Vendore						2033001
	Programi 8	04520	Kodi i Programit						
Art.	-1	-2	-3	-4	-5	-6	(7)=(6)-(5)		
	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 Mujore/progresiv	Fakti i Periudhes 12 mujore/progresiv	Diferenca		
600	Paga		0	0	0	0	0	0	
601	Sigurime Shoqërore		0	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		0	0	0	0	0	0	
603	Subvencione		0	0	0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme		0	0	0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja		0	0	0	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		0	0	0	0	0	0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente		0	0	0	0	0	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara		0	6468	6468	6468	3568	-2900	
231	Kapitale të Trupëzuara		12507				0	0	
232	Transferta Kapitale								
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		12507	6468	6468	6468	3568	-2900	
230	Kapitale të Patrupëzuara		0					0	
231	Kapitale të Trupëzuara		0					0	
232	Transferta Kapitale		0				0	0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale		12507	6468	6468	6468	3568	-2900	
	Totali (korrente + kapitale)		12507	6468	6468	6468	3568	-2900	
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Kryetari Njësishë Vetëqeverisjes Vendore		Hilmi LAKTI						
	Gjyjjana Miruku		Firma						
		22.02.2022	Data						

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikuive


KESHILLI QARKUT SHKODER

QARKU	SHKODER-		-1	-2	-3	-4	-5	-6	2033001
	Programi 9	04760							
Art.	Emertimi								
600		Paga	0	0	0	0	0	0	0
601		Sigurime Shoqërore	0	0	0	0	0	0	0
602		Mallra dhe Shërbime të Tjera	0	0	0	0	0	0	0
603		Subvencione	0	0	0	3934	3934	122	-3812
604		Transferta Korente të Brendshme	0	1200	0	0	0	0	0
605		Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606		Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	1200	3934	3934	0	0	0
Nen -Totali		Shpenzime Korrente	0	0	0	0	0	0	0
230		Kapitale të Patrupëzuara							
231		Kapitale të Trupëzuara							
232		Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali		Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0
230		Kapitale të Patrupëzuara/Projekti ADRIATICVES							
231		Kapitale të Trupëzuara							
232		Transferta Kapitale	0	0	0	2384	2384	747	-1637
Nen -Totali		Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	2384	2384	747	-1637
Totali		Shpenzime Kapitale	0	0	3934	6318	6318	869	-5449
		Totali (korrente + kapitale)	0	1200	3934	6318	6318	869	-5449
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Gjyjjana Miruku	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore		Hilimi LAKTI				
		Firma			Firma				
		Data		22.02.2022	Data				



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve
KESHILLI QARKUT SHKODER


ne 000/leke

QARKU	SHKODER	-1		-2	-3	-4	-5	-6	2033001
Programi 16	06330	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 Mujore/progresiv	Fakti i Periudhes 12 mujore/progresiv	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	i vitit paraardhës Viti 2020		Plan Viti 2021	Plan Fillestar Viti 2021	Plan i Periudhes 12 Mujore/progresiv	Fakti i Periudhes 12 mujore/progresiv	Diferenca	
600	Paga	0			0	0	0	0	
601	Signurime Shoqërore	0			0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0			0	0	0	0	
603	Subvencione	0			0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0			0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0			0	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0		0	0	0	0	
Non-Totali	Shpenzime Korrente	790			0	0	0	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	25236	51361	51361	51361	200	-51161	
231	Kapitale të Trupëzuara			11242	11242	0	0	0	
232	Transferta Kapitale			62603	62603	51361	200	-51161	
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	790	25236	62603	62603	51361	200	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0					0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0					0	0	
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale	790	25236	62603	62603	51361	200	-51161	
Totali	Totali (korrente + kapitale)	790	25236	62603	62603	51361	200	-51161	
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjana Miruku	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Hilmi LAKTI					
Firma		Firma							
Data		Data							

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujeve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke

QARKU	SHKODER	Kodi i Grupit / Njesisë Vendore		Kodi i Programit		2033001	
Programi 25	10460	-6		Fakti i Periudhes 12 mujore/progresiv		
Art.	Emertimi	-1	-2	-3	-4	-5	(7)=(6)-(5)
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12 Mujore/progresiv	Diferenca
600	Paga	0		0	0	0	0
601	Sigurime Shoqërore	0		0	0	0	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0		0	0	0	0
609	fond rezerve	0		0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0		0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0		0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1993		3024	6047	6047	-805.38
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	1993	0	3024	6047	6047	-805.38
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0		0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0		0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0		0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0		0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0
	Totali (korrente + kapitale)	1993	0	3024	6047	6047	-805.38
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyljana Miruku	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Hilmi LAKTI			
Firma		Firma					
Data	22.02.2022	Data					

Shenim; fonde te akorduara nga Ministria e Shendetise

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

KESHILLI QARKUT SHKODER

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2021 Kontraktuar	Plani i buxhetit vitit 2021 12/m	REALIZIMI PROGRESI V nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjet ore)	REALIZIMI PROGRESI V nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
0330042	Sistemim Asfalt rruga Bardhaj-Qafe Rrenc, F.III	136,600	2018			-	70,733	-	Fi,FiI,FiIII, Perfunduar	
0330045	Superviz Sist. Asfalt Bardhaj-Qafe Rrenc, F.III		2018			-	930	-	Fi,FiI,FiIII, Perfunduar	
0330046	Kolaud.Sist. Asfalt Bardhaj-qafe Rrenc, F.III		2018			-	81	-	Fi,FiI,FiIII, Perfunduar	
0330049	Ndertim ujesjellesi Muriqan		2021			51,361	200	-	pa realiz.inv	
0330048	Rikonstr.+Asfaltim I rrugeve te Farrez	4,000	2021	2021		4,000	3,568	-	Kontr.Dt 20/11	
0330007	Komputera		2021	2021		120	120	-	Ne Proçes	
0330021	Orendi zyre		2021	2021		120	81	-	Ne Proçes	
0330006	Te tjera Paisje zyre		2021	2021		62	-	-	Ne Proçes	
	Totali 12/Mujor					55,663	3,969	71,744		

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit vitit 2021	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjet ore)	REALIZIMI PROGRESI V nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESI nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
G033005	Projektë ADRIATICAVES	Grant/	6288	2018	2021	6288	2384	747	747	5541	Pr I perfund date 30/3/2021

Drejtesia e Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Gjyljana MIRUKU	Kryetari i	Hilmi LAKTI
	Firma	<i>[Signature]</i>	Njesisë	
	Data	22.02.2022	së	
			Vetëqever	22.02.2022